



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
Komisioni Institucional i Zgjedhjeve

Nr. 1/25 Prot.

Datë 18/06 /2024

UDHËZIM

**“Mbi zhvillimin e procesit të votimit
për zgjedhjen e autoriteteve dhe organeve drejtuese të Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”**

Bazuar në nenin 6, pika 3, shkronja “a” të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese dhe komisionet e përhershme, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, miratuar nga Senati Akademik i UMT-së me Vendimin nr. 36, datë 29.03.2024, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve në UMT,

UDHËZON:

1. Votimet për autoritetet drejtuese të të gjitha niveleve dhe Senatin Akademik të UMT-së zhvillohen në një ditë të vetme, në datën e caktuar nga Ministri përgjegjës për arsimin.
2. Administratorët e njësive ku do të zhvillohet procesi zgjedhor, duhet të japin mbështetjen e tyre, që në mjediset ku do të ngrihen qendrat e votimit, të ketë një vend hyrje dhe një vend dalje për votuesit.
3. Në mjediset përreth Qendrave të Votimit është e ndaluar rreptësisht prezenca e materialeve të fushatës zgjedhore nga secili kandidat garues.
4. Administratori i Njesisë Kryesore dhe KZF janë përgjegjës për garantimin e standardeve zgjedhore.
5. Në mjediset e njësive kryesore gjatë ditës së zgjedhjeve është e ndaluar kategorikisht fushata në mbështetje të kandidatëve garues. Personeli i administrimit në njësitë kryesore të UMT, duhet të marrë masat e nevojshme, në komunikim me KZF e njësisë ku po zhvillohet procesi i votimit.
6. Qendra e votimit hapet në orën 8:00 dhe mbyllet zyrtarisht në orën 16.00. Nëse edhe pas kalimit të këtij orari, ka ende votues që presin në radhë, mblidhen mjetet e tyre të identifikimit dhe procesi përfundon pasi edhe këta të fundit, të kenë votuar.
7. Qendra e votimit organizohet në një mënyrë të tillë që të lehtësojë procesin e votimit dhe të garantojë plotësisht fshehtësinë e votës. Në qendrën e votimit është i ndaluar përdorimi i mjeteve të komunikimit apo regjistrimit nga ana e votuesit.

8. Zgjedhësit qëndrojnë në radhë jashtë qendrës së votimit dhe futen njëri pas tjetrit në qendrën e votimit për të votuar, me thirrjen nga një anëtar i komisionit. Pasi hyn në qendrën e votimit zgjedhësi thotë emrin e tij, nëse është personel akademik apo student, njësinë bazë ku bën pjesë dhe paraqet **fizikisht** para komisionit një nga dokumentet zyrtare të vlefshme të identitetit me të dhëna biometrike:
- Letërnjoftim;
 - Pasaportë.
9. Kryetari, pasi verifikon se të dhënat e identitetit të zgjedhësit përputhen me të dhënat në listën e zgjedhësve dhe se zgjedhësi është i njëjtë me personin në dokumentin e identitetit, shënon në listën e zgjedhësve llojin dhe numrin e serisë së dokumentit të identitetit dhe i heq vizë emrit të zgjedhësit në këtë listë.
10. Zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve anash emrit të tij.
11. Zgjedhësit-personel akademik, i jepen për të votuar fletët e votimit për:
- Rektor,
 - Drejtues të njësisë kryesore (Dekan),
 - Përgjegjës departamenti në të cilin bën pjesë,
 - fleta e votimit për anëtarë të personelit akademik në Senatin Akademik.
 - Zgjedhësit-personel akademik në Fakultetin e Mjekësisë duhet të shënojë jo më shumë se, 12 (dymbëdhjetë) emra kandidatësh**, sa është numri i përfaqësuesve në Senatin Akademik që i përkasin këtij Fakulteti.
 - Zgjedhësit-personel akademik në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, duhet të shënojë jo më shumë se, 4 (katër) emra kandidatësh** sa është numri i përfaqësuesve në Senatin Akademik që i përkasin këtij Fakulteti.
 - Zgjedhësit-personel akademik në Fakultetin e Mjekësisë Dentare duhet të shënojë jo më shumë emra se, 2 (dy) emra kandidatësh** sa është numri i përfaqësuesve në Senatin Akademik që i përkasin këtij Fakulteti.
12. Zgjedhësit-student, i jepen për të votuar fletët e votimit për:
- Rektor;
 - Drejtues të njësisë kryesore (Dekan);
 - Anëtarë në Senatin Akademik përfaqësues i studentëve. Zgjedhësi student duhet të shënojë jo më shumë se, 2 (dy) emra kandidatësh** sa është numri i përfaqësuesve në Senatin Akademik që i përkasin kategorisë së studentëve.
13. Në rast të zgjedhjes të më shumë emrave se sa është numri përkatës i mandateve në Senatin Akademik, fleta e votimit bëhet e pavlefshme.
14. Çdo fletë votimi vulloset, në pjesën e pasme të saj me vulën e KZF-së dhe KQV-së. Në rastin kur procesi i votimit do të zhvillohet vetëm në një qendër votimi në njësinë kryesore dhe detyrat e komisionit të qendrës së votimit kryhen prej KZF-së, çdo fletë votimi vulloset në pjesën e pasme të saj, me vulën e KZF-së dhe të Kryetarit të KZF-së.
15. Pasi merr fletët e votimit zgjedhësi hyn në dhomën e fshehtë dhe:
- në fletën e votimit për Rektor, për drejtues të njësisë kryesore dhe për drejtues të njësisë bazë, shënon në krah të emrit të kandidatit shenjën "x"/ "+"/"√" ose ndonjë shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij. Shenja duhet të vendoset vetëm në krah të një emri.

- Në rastin kur për autoritet drejtues konkuron vetëm një kandidat zgjedhësi voton një nga alternativat e shkruajtura krahas emrit të kandidatit "Pro" ose "Kundër";
- ii. në fletën e votimit për anëtarë të Senatit Akademik shënon, në krah të emrave të kandidatëve shenjën "x"/ "+"/"√" ose ndonjë shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij.
 - iii. pasi bën shënimin në fletën e votimit, i palos fletët në mënyrë që të jenë të dukshme dy vulat përkatëse, del nga dhoma e fshehtë, i hedh fletët në kutitë përkatëse të votimit dhe largohet nga qendra e votimit.
16. Nëse shënimin në fletën e votimit apo në të paktën një nga fletët e votimit bëhet jashtë dhomës së fshehtë, zgjedhësi nuk lejohet të fusë fletën/fletët e votimit në kuti. Kryetari i qendrës e merr këtë fletë votimi, shënon në pjesën e pasme fjalët "E dëmtuar" dhe e fut atë në zarfin "Fletë votimi të dëmtuara". Në këtë rast, zgjedhësit i jepet një fletëvotimi tjetër e të njëjtit lloj dhe rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Nëse zgjedhësi shënon përsëri në fletën e votimit jashtë dhomës së fshehtë, edhe fleta e dytë e votimit futet në zarfin "Fletë votimi të dëmtuara" dhe zgjedhësit nuk i jepet më fletë votimi. Nëse zgjedhësi bën shënim ose e dëmton fletën e votimit pa dashje dhe kërkon një fletë votimi të dytë, fleta e votimit konsiderohet e dëmtuar dhe futet në zarfin "Fletë votimi të dëmtuara" dhe zgjedhësit i jepet një fletë e dytë votimi. Rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Nëse zgjedhësi shënon ose dëmton përsëri pa dashje fletën e dytë të votimit, edhe fleta e dytë e votimit futet në zarfin "Fletë votimi të dëmtuara" dhe zgjedhësit nuk i jepet më fletë votimi. Në asnjë rast fletët e votimit të dëmtuara nuk hidhen në kutitë e votimit.
17. Zgjedhësit të cilët, ditën e zhvillimit të zgjedhjeve nuk e kanë emrin në listën e zgjedhësve ose kanë gabime në përbërësit zgjedhorë, mund të votojnë vetëm në rastin kur me kërkesën e tyre, KIZ shprehet me vendim për të marrë pjesë në zgjedhje. Zgjedhësi i pajisur me vendimin e KIZ mund të votojë vetëm me paraqitjen e këtij Vendimi në Komisionin e Qendrës së Votimit.
18. Zgjedhësi i cili është i pajisur nga një Vendim të KIZ për të votuar, pasi hyn në QV e paraqet atë tek kryetari i komisionit në atë Qendër Votimi. Emri i këtij zgjedhësi dhe numri i kartës së identitetit të tij shënohet në një regjistër të veçantë, që më pas futet në kutinë e materialeve dhe dokumenteve të votimit për dorëzim në KIZ.
19. Në qendrën e votimit ndalohet kategorisht përdorimi i aparateve celulare apo i mjeteve të tjera regjistruese. Votuesi duhet të hyjë në dhomën e fshehtë i pa ngarkuar me çanta, mjete apo sende, qoftë edhe shkollore.
20. Në qendrën e votimit, gjatë procesit të votimit lejohen të qëndrojnë vetëm:
- i. anëtarët dhe sekretari i KZF/KQV-së;
 - ii. zgjedhësit që janë duke kryer procedurat e votimit deri në përfundim të tyre;
 - iii. vëzhguesit e akredituar nga KIZ;
 - iv. anëtarë të KIZ që monitorojnë procesin zgjedhor;
 - v. përfaqësues të MAS, në rast se paraqiten.

21. Pasi voton edhe zgjedhësi i fundit i pranishëm, komisioni merr vendim për mbylljen e votimit, duke plotësuar formularin përkatës, ku shënohet edhe ora e mbylljes së votimit. Pas kësaj, në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm anëtarët dhe sekretari i KZF/KQV-së, si dhe vëzhguesit e akredituar dhe kandidatët.
22. Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.



Adela Perolla

Edlira Rruci

Daniela Tasha

Fatmir Lela

Gentjan Asllanaj

Arnold Rrushi